



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR
PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE TË KONTRATËS SË ANËTARËSIMIT, TË
DEKLARATËS SË PRANIMIT TË PJESËMARRJES, TË KONTRATËS SË
ADMINISTRIMIT TË AKTIVEVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE DHE
PËRMBAJTJES E STRUKTURËS SË PROSPEKTIT TË FONDIT**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 2, datë 31.01.2024.

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore ka për objekt:

1. Përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit në fondin me pjesëmarrje të hapur për anëtarin individ;
2. Përcaktimin e elementëve të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, si për punëmarrësit e një punëdhënësi në fondin me pjesëmarrje të hapur, ashtu dhe për punëmarrësit e një sponsori në fondin me pjesëmarrje të mbyllur.
3. Përcaktimin e elementëve të kontratës së administrimit të aktiveve ndërmjet sponsorit dhe shoqërisë administruese, si dhe
4. Përmbajtjen dhe strukturën e prospektit të fondit të pensionit.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, pikës 8, të nenit 62, si dhe pikës 11, të nenit 100 të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

**Neni 3
Përkufizimet**

Përkufizimet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

KREU II

SEKSIONI I

ANËTARËSIMI NË FONDIN ME PJESËMARRJE TË HAPUR DHE FONDIN ME PJESËMARRJE TË MBYLLUR

Neni 4

Anëtarësim në fondin me pjesëmarrje të hapur

Anëtarësimi në fondin me pjesëmarrje të hapur bëhet nëpërmjet:

- a) Nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit individual, kur anëtari i fondit është individ, apo
- b) Nënshkrimit të kontratës midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për anëtarësimin e punëmarrësve në fondin me pjesëmarrje të hapur të zgjedhur nga punëdhënësi, si dhe nënshkrimit nga punëmarrësi të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes në fondin e pensionit me pjesëmarrje të hapur.

Neni 5

Anëtarësim në fondin me pjesëmarrje të mbyllur

Anëtarësimi në fondin me pjesëmarrje të mbyllur bëhet nëpërmjet:

- a) Nënshkrimit të kontratës së administrimit të aktiveve ndërmjet sponsorit dhe shoqërisë administruese;
- b) Nënshkrimit nga punëmarrësit e sponsorit, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes në fondin e pensionit me pjesëmarrje të mbyllur të krijuar nga sponsori.

SEKSIONI II

ELEMENTËT E KONTRATËS SË ANËTARËSIMIT NË FONDIN E PENSIONIT ME PJESËMARRJE TË HAPUR

Neni 6

Elementët e kontratës së anëtarësimit individual në fondin me pjesëmarrje të hapur

1. Kontrata individuale e anëtarësimit në një fond me pjesëmarrje të hapur, duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, por pa i kufizuar palët të shtojnë elementë ose kushte shtesë sipas dispozitave të ligjit nr. 76/2023.
2. Kontrata individuale e anëtarësimit në një fond me pjesëmarrje të hapur, duhet të përmbajë elementët si më poshtë:
 - a) Të dhënat për anëtarin e fondit të pensionit: emri, atësia dhe mbiemri, data e lindjes,

- vendlindja, shtetësia, numri personal për shtetasit shqiptarë dhe/ose numri i pasaportës për shtetasit e huaj, vendbanimi i përhershëm dhe/ose i përkohshëm, adresa, numri i telefonit, adresa e postës elektronike;
- b) Të dhënat për shoqërinë administruese: emri i shoqërisë, numri identifikues i personit të tatueshëm (NUIS), selia e regjistruar dhe zyra qendrore nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numri i licencës së dhënë nga Autoriteti, data e themelimit dhe ajo e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe emrat e përfaqësuesve ligjorë të saj;
 - c) Të dhënat për fondin e pensionit: emri i fondit, monedha bazë, lloji i fondit, numri dhe data e miratimit të fondit;
 - ç) Përshkrimin e saktë të objektit të kontratës;
 - d) Bazën ligjore të kontratës;
 - dh) Kushtet dhe procedurat për anëtarësimin, parashikimet për tërheqjen nga fondi i pensionit, si dhe mënyrat e pagesës pas plotësimit të kushteve të daljes në pension.
 - e) Të drejtën e anëtarit të fondit të pensionit për të kërkuar transferimin e aktiveve nga një fond në një tjetër, të administruar nga e njëjta shoqëri administruese apo nga një shoqëri tjetër administruese, si dhe procedurën e transferimit, përfshirë dhe komisionet dhe tarifatat përkatëse;
 - ë) Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të fondit të pensionit, përfshirë masën e kontributit në vlerë absolute ose si përqindje, konvertimin në kuota, frekuencën dhe mënyrën e pagesës së kontributit, si dhe kushtet për përfitimin e pensionit;
 - f) Detyrimet e shoqërisë administruese për informimin e anëtarit, për transparencë ndaj anëtarit, mënyrën dhe afatet e njoftimit, përfshirë detyrimin për pajisjen e anëtarit me vërtetimin për gjendjen e llogarisë, ruajtjen e konfidencialitetit;
 - g) Strategjinë e investimeve për fondin e pensionit, që përfshin një listë të kategorive të aktiveve ku mund të investohet fondi, si dhe një përshkrim përmbledhës të rreziqeve që lidhen me investimet;
 - gj) Detyrimin e shoqërisë administruese për të raportuar tek anëtari vlerën neto të aktiveve të fondit të pensionit;
 - h) Tarifatat, shpërblimet dhe çdo lloj të ardhurash që merret nga fondi i pensionit dhe i transferohet shoqërisë administruese, depozitarit dhe çdo personi tjetër. Kontrata duhet të përmbajë gjithashtu një listë të plotë të komisioneve dhe tarifave të tjera, që do të mbulohen nga aktivet e fondit të pensionit, si dhe ato që do të paguhet nga anëtari;
 - i) Të dhënat për depozitarin e fondit: emri i shoqërisë, numri identifikues si person i tatueshëm (NUIS), selia e regjistruar dhe zyra qendrore nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numri i licencës të dhënë nga Autoriteti dhe nga Banka e Shqipërisë, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë së tij në raport me fondin.
 - j) Mënyrat dhe afatet e njoftimit anëtarit të fondit mbi gjendjen në llogarinë individuale;
 - k) Pagesën e aktiveve në rastin e humbjes së jetës së anëtarit;
 - l) Dispozitë për trajtimin fiskal sipas legjislacionit në fuqi;
 - ll) Përcaktimin se mosvazhdimi i pagesave të kontributeve:
 - i. nuk nënkupton ndërprerjen e anëtarësimit në fond;
 - ii. nuk nënkupton se anëtari do të penalizohet në rast se në emër dhe për llogari të tij nuk paguhet kontribute.
 - m) Kohëzgjatjen e kontratës, mënyrën e zgjidhjes së saj dhe gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

- n) Dispozita përfundimtare.
3. Kontrata duhet të përmbajë konfirmimin e anëtarit që anëtarësohet në fond, nëpërmjet të cilit ai shpreh dakordësinë se ka kuptuar dhe pranuar kushtet e kontratës, përmbajtjen e prospektit, ka marrë përsipër rrezikun e mundshëm të investimit si dhe tarifën që aplikohen. Kontrata duhet të përfshijë edhe datën e nënshkrimit.

Neni 7

Elementët e deklaratës mbi pranimin e pjesëmarrjes në fondin e pensionit me pjesëmarrje të hapur të zgjedhur nga punëdhënësi

1. Deklarata e punëmarrësit mbi pranimin e pjesëmarrjes në fondin me pjesëmarrje të hapur të përzgjedhur nga punëdhënësi, është një dokument ligjor që përshkruan termat dhe kushtet kryesore sipas të cilave një individ pranon të jetë anëtar i fondit të pensionit. Deklarata e punëmarrësit mbi pranimin e pjesëmarrjes në fondin me pjesëmarrje të hapur, duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, por pa i kufizuar palët të shtojnë elementë ose kushte shtesë sipas dispozitave të ligjit nr. 76/2023.
2. Deklarata e pranimin të pjesëmarrjes duhet të përmbajë elementët si më poshtë:
 - a) Titullin e deklaratës me këtë emërtesë: “Deklaratë e pranimin të pjesëmarrjes së punëmarrësit në fondin me pjesëmarrje të hapur të përzgjedhur nga punëdhënësi”;
 - b) Të dhënat për anëtarin e fondit të pensionit: emri, atësia dhe mbiemri, data e lindjes, vendlindja, shtetësia, numri personal për shtetasit shqiptarë dhe/ose numri i pasaportës për shtetasit e huaj, vendbanimi i përhershëm dhe/ose i përkohshëm, adresa, numri i telefonit, adresa e postës elektronike;
 - c) Për punëdhënësin: emri i shoqërisë, selia e regjistruar dhe zyra qendrore, numri identifikues i personit të tatueshëm (NUIS) si dhe emrat e përfaqësuesve ligjorë;
 - ç) Të dhënat për shoqërinë administruese: emri i shoqërisë, numri identifikues i personit të tatueshëm (NUIS), selia e regjistruar dhe zyra qendrore nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numri i licencës së dhënë nga Autoriteti, data e themelimit dhe ajo e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe emrat e përfaqësuesve ligjorë të saj;
 - d) Të dhënat për fondin e pensionit: emri i fondit, monedha bazë, lloji i fondit, numri dhe data e miratimit të fondit;
 - dh) Të dhënat për depozitarin e fondit: emri i shoqërisë, numri identifikues si person i tatueshëm (NUIS), selia e regjistruar dhe zyra qendrore nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numri i licencës të dhënë nga Autoriteti dhe nga Banka e Shqipërisë;
 - e) Kontributet e punëmarrësit dhe punëdhënësit ku të specifikohet shuma e kontributit në vlerë absolute ose si përqindje ndaj pagës, frekuencën dhe mënyrën e pagesës;
 - ë) Periudhën përpara se punëmarrësit t’i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi nëse është e zbatueshme;
 - f) Shprehjen e dakordësisë së punëmarrësit për të zbritur nga paga e tij kontributet për fondin e pensionit, si dhe përgjegjësinë e punëdhënësit lidhur me zbritjen dhe pagesën e kontributeve në emër të punëmarrësit, sipas parashikimeve ligjore;
 - g) Datën e nënshkrimit të kësaj deklarate.
3. Deklarata e pranimin të pjesëmarrjes duhet të shoqërohet me një kopje të prospektit të fondit

i cili do t'i bashkëngjitet deklaratës.

Neni 8

Elementët e kontratës midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për anëtarësimin e punëmarrësve të tij në fondin me pjesëmarrje të hapur

1. Punëdhënësi i cili kontribuon në një fond pensioni për punëmarrësit e tij lidh një kontratë me shoqërinë administruese përgjegjëse për administrimin e fondit me pjesëmarrje të hapur të zgjedhur nga punëdhënësi. Kontrata midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, por pa i kufizuar palët të shtojnë elementë ose kushte shtesë sipas dispozitave të ligjit nr. 76/2023.
2. Kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe shoqërisë administruese duhet të përmbajë elementët si më poshtë:
 - a) Për punëdhënësin: emri i shoqërisë, selia e regjistruar dhe zyra qendrore, numri identifikues i personit të tatueshëm (NUIS) si dhe emrat e përfaqësuesve ligjorë;
 - b) Periudhën përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi nëse është e zbatueshme;
 - c) Dispozitë për trajtimin fiskal sipas legjislacionit në fuqi;
 - ç) Të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrimet e punëdhënësit, duke përfshirë ndër të tjera:
 - i. Zbritjen dhe pagesën e kontributeve në emër të punëmarrësve, përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe detyrimin e tij për të vepruar në interesin më të mirë të pjesëmarrësve në fondin e pensionit;
 - ii. Detyrimin e punëdhënësit që të pajisë shoqërinë administruese me skedulën e kontributeve, përfshirë shumën e kontributit të derdhur nga punëdhënësi për secilin punëmarrës dhe shumën e kontributit të derdhur nga vetë punëmarrësi në fondin e pensionit.
 - d) Tarifat, shpërblimet dhe çdo lloj të ardhure që merret nga fondi i pensionit dhe i transferohet shoqërisë administruese, depozitarit dhe çdo personi tjetër. Kontrata duhet të përmbajë gjithashtu një listë të plotë të komisioneve dhe tarifave të tjera, që do të mbulohen nga aktivet e fondit të pensionit, si dhe ato që do të paguhen nga anëtari;
 - dh) Kohëzgjatjen e kontratës, mënyrën e zgjidhjes së saj dhe gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
 - e) Dispozita përfundimtare.
3. Kontrata midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për anëtarësim të punëmarrësve të tij në fondin me pjesëmarrje të hapur, shoqërohet me një kopje të prospektit të fondit.

SEKSIONI III

ELEMENTËT E KONTRATËS SË ADMINISTRIMIT TË AKTIVEVE NDËRMJET SPONSORIT DHE SHOQËRISË ADMINISTRUESE, SI DHE DEKLATARËS SË ANËTARËSIMIT NË FONDIN ME PJESËMARRJE TË MBYLLUR

Neni 9

Elementët e kontratës së administrimit të aktiveve ndërmjet sponsorit dhe shoqërisë administruese

1. Kontrata e administrimit të aktiveve ndërmjet sponsorit dhe shoqërisë administruese është një dokument ligjor që rregullon marrëdhëniet midis palëve. Kjo kontratë përcakton përgjegjësitë e palëve për administrimin e aktiveve të fondit, siguron transparencë dhe pajtueshmëri me kuadrin ligjor, si dhe mbrojtjen e interesave të pjesëmarrësve në fondin me pjesëmarrje të mbyllur të krijuar nga punëdhënësi. Kontrata midis sponsorit dhe shoqërisë administruese duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, por pa i kufizuar palët të shtojnë elementë ose kushte shtesë sipas dispozitave të ligjit nr. 76/2023.
2. Kontrata e administrimit të aktiveve ndërmjet sponsorit dhe shoqërisë administruese, duhet të përmbajë elementët si më poshtë:
 - a) Të dhënat për shoqërinë administruese: emri i shoqërisë, numri identifikues i personit të tatueshëm (NUIS), selia e regjistruar dhe zyra qendrore nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numri i licencës së dhënë nga Autoriteti, data e themelimit dhe ajo e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe emrat e përfaqësuesve ligjorë të saj;
 - b) Të dhënat për sponsorin: emri i shoqërisë/shoqërive, selia e regjistruar dhe zyra qendrore, numri identifikues i personit të tatueshëm (NUIS) si dhe emrat e përfaqësuesve ligjorë;
 - c) Të dhënat për fondin e pensionit: emri i fondit, monedha bazë, lloji i fondit, numri dhe data e miratimit të fondit;
 - ç) Të dhënat për depozitarin e fondit: emri i shoqërisë, numri identifikues si person i tatueshëm (NUIS), selia e regjistruar dhe zyra qendrore nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numri i licencës të dhënë nga Autoriteti dhe nga Banka e Shqipërisë, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë së tij në raport me fondin.
 - d) Shërbimet që do të ofrojë shoqëria administruese;
 - dh) Strategjinë dhe objektivat e investimeve që do të zbatohet për fondin e pensionit që përfshin kategorinë e aktiveve ku mund të investohet fondi, hartuar në përputhje me tolerancën ndaj rrezikut dhe interesin më të mirë të anëtarëve të fondit me pjesëmarrje të mbyllur;
 - e) Procedurat dhe kontrollet e administrimit të rrezikut që do të zbatohen nga shoqëria administruese për të mbrojtur aktivet e fondit të pensionit privat, ku do të përfshihet vlerësimi i rrezikut, masat dhe strategjitë e zbutjes;
 - ë) Tarifat, shpërblimet dhe çdo lloj të ardhure që merret nga fondi i pensionit dhe i transferohet shoqërisë administruese, depozitarit dhe çdo personi tjetër. Kontrata duhet të përmbajë gjithashtu një listë të plotë të komisioneve dhe tarifave të tjera, që do të mbulohen nga aktivet e fondit të pensionit, si dhe ato që do të paguhen nga anëtari;
 - f) Të drejtat dhe detyrimet e sponsorit;
 - g) Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë administruese;
 - gj) Raportimin dhe transparencën, ku do të përshkruhen kërkesat e raportimit, duke siguruar që sponsori dhe pjesëmarrësit të marrin raporte të rregullta dhe të detajuara mbi performancën e fondit dhe mbi çdo çështje tjetër;
 - h) Komunikimin me anëtarët e fondit, duke përfshirë informacione shpjeguese mbi fondin e pensionit, investimet, si dhe raportimin e gjendjes së llogarisë së anëtarit;
 - i) Trajtimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- j) Termat dhe kushtet sipas të cilave një ose më shumë prej subjekteve të cilat formojnë sponsorin mund të tërhiqen, në rastet kur kemi të bëjmë me dy ose më shumë subjekte;
 - k) Periudhën përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi nëse është e zbatueshme;
 - l) Trajtimin e ankesave;
 - ll) Konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të anëtarëve;
 - m) Kohëzgjatjen e kontratës, mënyrën e zgjidhjes së saj dhe gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
 - n) Dispozita përfundimtare.
3. Kontrata midis sponsorit dhe shoqërisë administruese për administrimin e aktiveve ndërmjet sponsorit dhe shoqërisë administruese, shoqërohet me një kopje të prospektit të fondit.

Neni 10

Elementët e deklaratës së pranimin të pjesëmarrjes së punëmarrësit në fondin me pjesëmarrje të mbyllur të krijuar nga sponsori

1. Përveç elementëve të deklaratës të përcaktuar në shkronja “b” deri në “g”, të pikës 2, të nenit 7 të kësaj rregullore, deklarata e punëmarrësit lidhur me pranimin e pjesëmarrjes në fondin e pensionit të krijuar nga sponsori duhet të përmbajë dhe elementët si më poshtë:
 - a) Titullin e deklaratës me këtë emërtesë: “Deklaratë e pranimin të pjesëmarrjes së punëmarrësit në fondin me pjesëmarrje të mbyllur të krijuar nga sponsori”;
 - b) Të dhënat për sponsorin: emri i shoqërisë/shoqërive, selia e regjistruar dhe zyra qendrore, numri identifikues i personit të tatueshëm (NUIS) si dhe emrat e përfaqësuesve ligjorë;
 - c) Informacion mbi mënyrat dhe afatin se kur punëmarrësit do i vihet në dispozicion gjendja e llogarisë së tij si dhe për çdo raportim mbi performancën e fondit dhe kthimin nga investimi;
 - ç) Informacione mbi rrezikun e investimit.
2. Deklarata e punëmarrësit mbi pranimin e pjesëmarrjes në fondin me pjesëmarrje të mbyllur të krijuar nga sponsori duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, por pa i kufizuar palët të shtojnë elementë ose kushte shtesë sipas dispozitave të ligjit nr. 76/2023.
3. Deklarata gjithashtu duhet të shoqërohet me një kopje të prospektit të fondit i cili do t'i bashkëngjitet deklaratës.

SEKSIONI IV RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 11

Rregulla të përgjithshme të kontratës të fondit të pensionit

1. Shoqëria administruese përgatit kontratën tip të anëtarësimit për individin në fondin me pjesëmarrje të hapur.
2. Kontrata tip e anëtarësimit dhe çdo ndryshim i saj miratohet nga Autoriteti.
3. Shoqëria administruese ka të drejtë të përdorë vetëm kontratën e miratuar nga Autoriteti.
4. Kontrata e miratuar, publikohet në faqen e internetit të shoqërisë administruese;
5. Kontrata e fondit të pensionit duhet të shkruhet në gjuhë të kuptueshme dhe të paraqitet në formë të thjeshtë;
6. Kontrata e anëtarësimit të individit nënshkruhet vetëm pasi anëtari është njohur me prospektin e fondit të pensionit;
7. Me nënshkrimin e kontratës së anëtarësimit shoqëria administruese detyrohet të regjistrojë anëtarin në regjistrin e anëtarëve. Shoqëria administruese pas kryerjes së pagesës së parë në llogarinë e fondit duhet të hapë një llogari personale në emër të anëtarit të fondit, të bëjë konvertimin e kontributit në kuota dhe ta pajisë anëtarin me kredencialet përkatëse, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e tjera ligjore të nevojshme për administrimin e fondit të pensionit.
8. Një kopje origjinale e kontratës së anëtarësimit duhet t'i dorëzohet anëtarit individ.
9. Kontrata ndërmjet sponsorit dhe shoqërisë administruese për administrimin e aktiveve në rastin e fondit të mbyllur, si dhe kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për anëtarësimin në fondin me pjesëmarrje të hapur duhet të shkruhet në gjuhë të kuptueshme dhe të paraqitet në formë të thjeshtë. Këto kontrata miratohen nga Autoriteti.

Neni 12

Rregulla të përgjithshme të deklaratës së pranimiit të pjesëmarrjes, në fondin e pensionit me pjesëmarrje të hapur dhe fondin me pjesëmarrje të mbyllur

1. Punëdhënësi/sponsori, vetëm pasi zgjedh fondin me pjesëmarrje të hapur nëpërmjet nënshkrimit të kontratës me shoqërinë administruese ose krijon fondin me pjesëmarrje të mbyllur pas negociimit me shoqërinë administruese, ka të drejtë të shpërndajë deklaratat e pranimiit të pjesëmarrjes të punëmarrësit për nënshkrim.
2. Deklarata e pranimiit të pjesëmarrjes duhet të shkruhet në gjuhë të qartë, të kuptueshme dhe të paraqitet në formë të thjeshtë për të siguruar që pjesëmarrësit të kuptojnë plotësisht të drejtat dhe përgjegjësitë lidhur me pjesëmarrjen në fondin e pensionit.
3. Deklarata e pjesëmarrjes nënshkruhet, vetëm pasi anëtari i mundshëm është njohur me prospektin e fondit të pensionit.
4. Deklarata duhet të përfshijë një hapësirë për nënshkrimin e punëmarrësit që tregon pranimin e termave dhe kushteve të përshkruara në deklaratë dhe se prospekti i fondit është bashkëlidhur deklaratës.
5. Secili punëmarrës me vullnetin e tij, nënshkruan deklaratën e pranimiit të pjesëmarrjes në fondin e pensionit.
6. Një kopje origjinale e deklaratës i dorëzohet punëmarrësit, punëdhënësit dhe/ose sponsorit të tij.
7. Punëdhënësi/sponsori njofton shoqërinë administruese për nënshkrimin e deklaratës së pranimiit të pjesëmarrjes nga punëmarrësi.
8. Me nënshkrimin e deklaratës së pranimiit të pjesëmarrjes shoqëria administruese detyrohet të regjistrojë anëtarin në regjistrin e anëtarëve. Shoqëria administruese pas kryerjes së pagesës së parë në llogarinë e fondit duhet të hapë një llogari personale në emër të anëtarit të fondit, të bëjë

- konvertimin e kontributit në kuota dhe ta pajisë anëtarin me kredencialet përkatëse, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e tjera ligjore të nevojshme për administrimin e fondit të pensionit.
9. Në rast të ndryshimit të elementëve të deklarates të pranimit të pjesëmarrjes, anëtari i fondit nënshkruan deklaratën me të dhënat e reja.

KREU III

PROSPEKTI I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT

Neni 13

Përmbajtja e prospektit të fondit me pjesëmarrje të hapur dhe pjesëmarrje të mbyllur

1. Prospekti në hyrje të tij, duhet të përfshijë:
 - a) Datën më të fundit të miratimit të tij;
 - b) Deklarimin që prospekti i fondit të pensionit nuk përfaqëson ftesë për anëtarësim në fond, por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat, rreziqet që mbart anëtarësimi në një fond pensioni privat;
 - c) Deklarimin që organizimi dhe administrimi i fondit të pensionit kryhet ekskluzivisht nga shoqëria administruese e fondit të pensionit dhe se shoqëria administruese është përgjegjëse për përmbajtjen e prospektit të fondit të pensionit privat;
 - ç) Deklarimin se aktivet e fondit nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të shoqërisë administruese;
 - d) Deklarimin se aktivet e fondit të pensionit veçohen nga aktivet e shoqërisë administruese dhe nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit të shoqërisë administruese dhe se fondi nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit;
 - dh) Deklarimin që aktivet e fondit me pjesëmarrje të hapur janë tërësisht të ndara nga aktivet e fondit me pjesëmarrje të mbyllur dhe nga aktivet e tjera të administruara nga shoqëria administruese;
 - e) Informacion për funksionimin e skemës me kontribute të përcaktuara dhe mbajtësin e rrezikut të investimit.
 - ë) Deklarimin se shoqëria administruese është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar anëtarit të fondit nga veprimet ose mosveprimet e saj, nëse dokumentet ose informacioni i parashikuar në prospekt përmbajnë të dhëna dhe informacione të pavërteta ose të paplota.
2. Prospekti duhet të përmbajë përveç kërkesave që përcaktohen në ligjin nr.76/2023 dhe kërkesave të pikës 1 të këtij neni, edhe të dhënat e mëposhtme për fondin:
 - a) Datën e miratimit të prospektit të parë si dhe numrin e Vendimit të Bordit të Autoritetit;
 - b) Çmimin fillestar të kuotës;
 - c) Datën e fillimit të veprimtarisë së fondit, që nënkupton datën e publikimit të çmimit të kuotës për herë të parë;
 - ç) Drejtimit kryesorë të politikës së investimeve të fondit me pjesëmarrje të hapur dhe fondit me pjesëmarrje të mbyllur si dhe rregullat e administrimit të rrezikut ku përfshihen:
 - i. Shpjegimi i termave që lidhen me politikën e investimeve;
 - ii. Identifikimi i rreziqeve përfshirë rrezikun e tregut, rrezikun e kreditit, rrezikun operacional, rrezikun e agjencisë, rrezikun ligjor dhe reputacional;
 - iii. Përqindja maksimale dhe/ose minimale e aktiveve të fondit që mund të investohen në

- lloje të ndryshme instrumentesh financiare, depozita bankare, në përputhje me politikën e investimit të fondit;
- iv. Procedura për vendimmarrjen e investimeve, e cila duhet të përshkruajë qartë njësitë organizative të përfshira në miratimin, zbatimin dhe rishikimin e saj.
 - v. Procedura se si mund të ndryshojë politika e investimit dhe shpjegimi i qartë mbi procedurat dhe afatet e njoftimit të anëtarëve të fondit mbi ndryshimet në politikën e investimit;
 - vi. Tarifa e administrimit që aplikohet për sipërmarrjet e investimeve kolektive të cilat investon fondi i pensionit. Nëse vlera e aktiveve të fondit të pensionit mund të ketë luhatshmëri për shkak të investimeve në aksione dhe kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, një deklaratë e qartë duhet të përfshihet.
- d) Kthimin nga investimi me bazë vjetore, të paraqitur me shifra dhe grafikisht, duke përfshirë edhe shënimin që niveli i kthimit nga investimi nuk përbën garanci ose premtim. Nëse kthimi i investimeve bazohet në performancën bruto, duhet të paraqitet efekti i komisioneve, tarifave ose pagesave të tjera. Paraqitja e kthimit nga investimi me bazë vjetore përveç kërkesës së pikës 5, të nenit 100, të ligjit nr.76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, duhet të jetë në përputhje edhe me kërkesat e mëposhtme:
- i) Kthimet e investimeve për një periudhë më të shkurtër se një vit nuk mund të paraqiten;
 - ii) Për fondet e pensionit që kanë kryer aktivitet më pak se një vit, kthimet nga investimi duhet të shfaqen deri në fund të tremujorit më të fundit para publikimit të prospektit;
 - iii) Nëse janë paraqitur kthimet kumulative të investimeve për një periudhë të caktuar, duhet të paraqitet edhe norma e rritjes në përqindje për çdo vit të periudhës kumulative;
 - iv) Periudha e referencës për të cilën citohet performanca dhe burimi i të dhënave deklarohen qartë;
- dh) Shumën minimale të kontributit të pensionit;
- e) Paraqitjen në mënyrë të detajuar të të gjitha komisioneve dhe tarifave që do të mbahen nga aktivet e fondit të pensionit dhe nga aktivet e anëtarëve si dhe të jepet informacion për mënyrën e mbatjes dhe pagesës së tyre. Në prospekt duhet të përfshihet kostoja totale vjetore që do t’i zbritet aktiveve të fondit të pensionit, si dhe nivelin maksimal të këtyre kostove të shprehur në përqindje ndaj vlerës neto të aktiveve të fondit;
 - ë) Metodologjinë e vlerësimit të aktiveve të fondit sipas rregullave në fuqi për vlerësimin e aktiveve të fondit të pensionit;
 - f) Të drejtat dhe përgjegjësitë e shoqërisë administruese të fondit dhe anëtarëve të fondit si dhe procedurat e ndjekura në rast të transferimit të aktiveve të llogarisë individuale në një fond tjetër si dhe rast të tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit privat;
 - g) Kërkesat që duhet të plotësohen nga anëtari i fondit për të përfituar të drejtën e tërheqjes në mënyrë të menjëhershme të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij ose të pagesave periodike në formë pensioni, si edhe periudhën kohore më të shkurtër që mund të zbatohet në kontratë për tërheqjen e pagesave periodike;
 - gj) Mënyrën, procedurën dhe afatet e kryerjes së pagesave nga shoqëria administruese;
 - h) Mënyrën dhe opsionet e pagesave të kontributeve;
 - i) Kohën e kryerjes së pagesës së kontributeve të sponsorit në llogaritë personale të anëtarëve;
 - j) Informacionin se konvertimi i kontributeve në kuota do të kryhet me çmimin e kuotës të ditës së mbërritjes së pagesës në llogarinë e fondit dhe se konvertimi i kuotave në para në rastin e pagesave të pensionit, tërheqjeve të parakohshme dhe transferimit në një fond tjetër pensioni do të kryhet me çmimin e kuotës së ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për

tërheqje;

- k) Në rastin kur anëtari gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “*anuiteti*”, lëshuar nga një shoqëri sigurimi të jetës e licencuar nga Autoriteti, kjo praktikë duhet të sqarohet në prospekt;
 - l) Informacionin se vlera neto e aktiveve të fondit dhe çmimi i kuotës llogariten çdo ditë nga shoqëria administruese, të cilat pasi kontrollohen dhe verifikohen nga depozitari i fondit të pensionit, i cili është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes, publikohen në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese;
 - ll) Informacionin se si do të njoftohet anëtari në rastet kur faqja zyrtare e internetit ka probleme teknike dhe është i pamundur publikimi i vlerës neto të aktiveve të fondit, çmimit të kuotës si dhe i çdo informacioni që lidhet me fondin e pensionit;
 - m) Të përcaktohen qartë kushtet ose rrethanat në të cilat mbyllet llogaria personale e anëtarit në fondin e pensionit;
 - n) Informacionin mbi ndryshimet e rëndësishme në prospekt, për të cilat kërkohet miratim nga Autoriteti;
 - nj) Njoftimin se çdo rritje e komisioneve të zbatuara nga shoqëria administruese brenda kufirit të përcaktuar në ligj duhet t’u njoftohet anëtarëve, të paktën, 6 (gjashtë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi;
 - o) Informacionin se brenda 10 ditëve pune nga dita e marrjes së miratimit nga Autoriteti, shoqëria administruese dërgon një njoftim me postë normale ose me postë elektronike të gjithë anëtarëve të fondit për ndryshimet e rëndësishme në prospekt;
 - p) Informacionin se brenda 30 ditëve pune nga dita e njoftimit të anëtarëve dhe publikimit të njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 102 të ligjit, çdo anëtar i fondit mund të kërkojë ndryshimin e fondit të pensionit, pa paguar komision transferimi;
 - q) Detyrimin e shoqërisë administruese për të informuar anëtarin 3 muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aktiveve neto në llogarinë e tij të pensionit sipas nenit 73, pika 1 të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, në lidhje me vlerësimin aktual të llogarisë individuale, pajisjen me opsionet për mënyrat e pagesës së pensionit, si dhe me udhëzime për zbatimin e mënyrave të pagesës;
 - r) Informacionin për mënyrat dhe afatet e informimit të anëtarit nga shoqëria administruese sipas pikës 6, të nenit 110, të ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”;
 - rr) Dispozita për trajtimin fiskal sipas legjislacionit në fuqi
 - s) Dispozita mbi bashkimin, ndarjen dhe shndërrimin e fondeve;
 - sh) Dispozita mbi likuidimin vullnetar dhe të detyrueshëm të shoqërisë administruese;
 - t) Informacionin për lidhjen e kontratës në largësi për anëtarin, nëse kjo praktikë do të zbatohet nga shoqëria administruese, në mënyrë të përmbledhur, të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme;
 - th) Informacionin se fondet në llogarinë personale të një anëtarit të fondit trashëgohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon të drejtën e trashëgimisë.
3. Prospekti duhet të përmbajë një kapitull të veçantë me të dhënat e 31 dhjetor të vitit ushtrimor paraardhës mbi fondin, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur, të dukshme dhe të qartë në lidhje me:
- a) Vlerën e aktiveve neto të fondit;
 - b) Strukturën e aktiveve të fondit për 31 dhjetor të vitit ushtrimor paraardhës, ndarjen në përqindje sipas tipeve të investimeve: instrumente financiare, depozita bankare, etj., së bashku me kufijtë e investimeve që zbatohen për llojet e investimeve;

- c) Informacionin mbi të gjitha tarifat dhe komisionet që janë mbajtur nga aktivet e fondit të shprehur si % ndaj vlerës neto të aktiveve, mënyrën e llogaritjes së tyre si dhe nivelin maksimal të totalit të tyre.
4. Prospekti gjithashtu duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme për shoqërinë administruese të fondit:
- a) Emrin e shoqërisë dhe formën ligjore, numrin identifikues të personit të tatueshëm (NIPT), selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore, nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numrin e licencës të dhënë nga Autoriteti, datën e themelimit dhe atë të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe emrat e përfaqësuesve ligjorë të saj;
 - b) Adresën e shoqërisë administruese dhe sponsorit, në rastin e veprimtarisë ndërkufitare adresën e shoqërisë administruese të njohur;
 - c) Listën e fondeve të tjera të pensionit me pjesëmarrje të hapur dhe/ose të mbyllur dhe sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive, nëse shoqëria administruese administron edhe fonde e sipërmarrje të tjera;
 - ç) Shumën e kapitalit të regjistruar të shoqërisë administruese dhe emrat e aksionarëve të shoqërisë administruese, formën ligjore dhe pjesëmarrjen e aksionarëve në kapitalin e regjistruar;
 - d) Përshkrimin e qartë të roleve dhe përgjegjësisve të Këshillit të Administrimit, Komitetit të Investimeve, administratorit, drejtorit të njësisë së riskut dhe drejtorit të njësisë së menaxhimit të portofolit;
 - dh) Deklaratën se: “Shoqëria administruese mban përgjegjësi të plotë për përmbushjen dhe mbarëvajtjen e çdo funksioni të deleguar”;
 - e) Të dhëna mbi audituesin ligjor të shoqërisë administruese dhe të fondit të pensionit privat, ku të përfshihet: adresa e tij, statusi i tij profesional dhe emrat e personave përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare;
 - ë) Informacionin mbi mënyrën e trajtimit të ankesave duke përcaktuar afatet si dhe adresat e kontaktit;
5. Prospekti përveç kërkesave që përcaktohen në ligj për depozitarin, duhet të përmbajë edhe të dhënat e mëposhtme:
- a) Emrin e shoqërisë, formën ligjore, selinë dhe adresën depozitarit, numrin dhe të dhënat për licencat përkatëse nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti për kryerjen e veprimtarisë;
 - b) Përgjegjësitë e depozitarit të fondit të pensionit privat lidhur me regjistrin e kuotave të fondit;
 - c) Informacionin se depozitari është dhe do të vijojë të mbetet tërësisht i pavarur nga shoqëria administruese dhe nga çdo palë tjetër, që ka lidhje me shoqërinë administruese.

Neni 14

Rregulla të Përgjithshme mbi Prospektin

1. Data e miratimit të fondit të pensionit privat është data e miratimit të kontratës dhe prospektit nga Autoriteti.

2. Anëtarësimi në një fond pensioni privat në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm pas miratimit nga Autoriteti të prospektit të fondit të pensionit.
3. Shoqëria administruese ka të drejtë të përdorë vetëm kontratën e fondit të pensionit privat dhe prospektin e tij, të miratuara nga Autoriteti.
4. Prospekti shkruhet në gjuhë të qartë, lehtësisht të lexueshme dhe lehtësisht të kuptueshme për të gjithë individët.
5. Prospekti publikohet në gjuhën shqipe në faqen e internetit të shoqërisë administruese dhe u shpërndahet falas anëtarëve aktualë dhe/ose atyre të mundshëm;
6. Prospekti i fondit të pensionit, rishikohet çdo vit, përditësohet dhe depozitohet në Autoritet jo më vonë se data 31 mars e çdo viti. Shoqëria administruese duhet të informojë me shkrim Autoritetin se në cilat pjesë është përditësuar prospekti. Gjithashtu, nëse prospekti ka ndryshime të rëndësishme, shoqëria administruese depoziton pranë Autoritetit vendimin dhe kërkesën për miratimin e tyre;
7. Çdo ndryshim i rëndësishëm i prospektit të fondit të pensionit miratohet nga Autoriteti sipas parashikimeve të nenit 99, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.
8. Në lidhje me ndryshimet e rëndësishme të prospektit, në njoftimin e dërguar anëtarëve të fondit në përputhje me pikën 4, të nenit 102 të ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, shoqëria administruese është e detyruar të deklarojë:
 - a) Cilat janë ndryshimet e rëndësishme në prospekt;
 - b) Datën e publikimit të njoftimit;
 - c) Ditën në të cilën ndryshimet e rëndësishme hyjnë në fuqi.
9. Prospekti mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera që shoqëria administruese e fondit i shikon si të dobishme për të dhënë një pasqyrë më të mirë për fondin;
10. Shoqëria administruese e fondit të pensionit privat është përgjegjëse për përmbajtjen e prospektit të fondit dhe në rastin e fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur, shoqëria administruese mban përgjegjësi individualisht dhe bashkërisht me sponsorin për përmbajtjen e prospektit;
11. Prospekti i fondit shoqërohet nga kontrata e anëtarësimit dhe deklarata e pranimi të pjesëmarrjes në fond;
12. Shoqëria administruese dhe agjentët e fondit të pensionit privat nuk do të lidhin kontratë fondi të pensionit me asnjë person, pa i vënë më parë në dispozicion një kopje të prospektit;
13. Brenda pesë ditëve, pas marrjes së njoftimit me shkrim për miratimin e prospektit nga Autoriteti, shoqëria administruese publikon prospektin në faqen e saj të internetit;
14. Shoqëria administruese i dorëzon prospektin secilit anëtar të fondit me kërkesën e tij, pa kosto.
15. Prospekti i vihet në dispozicion anëtarit pa pagesë, në formë të shtypur në letër përpara nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit ose deklaratës së pranimi të pjesëmarrjes dhe sipas kërkesës, i mundësohet edhe në format elektronik nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi. Prospekti i përditësuar, gjithashtu, vendoset për t’u shkarkuar në një vend të dukshëm në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.